

MARREVESHJA E BASHKIMIT ME PERTHITHJE

Ndermjet

“CONCORD INVESTMENT” SH.P.K.

Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

“ILIRIA DEVELOPMENT” SH.P.K.

Si Shoqëri e Përthithur

Two blue ink signatures are present at the bottom of the page. The signature on the left is a stylized, cursive 'G' followed by a vertical line. The signature on the right consists of several parallel diagonal lines.

“CONCORD INVESTMENT” SH.P.K.

Nr. 15/2 Prot.

Tiranë, 29/07/2021

“ILIRIA DEVELOPMENT” SH.P.K.

Nr. 02/2 Prot

Tiranë, 29/07/2021

**MARREVESHJE BASHKIMI ME PERTHITHJE
E SHOQERISE “ILIRIA DEVELOPMENT” SH.P.K. NGA SHOQERIA “CONCORD
INVESTMENT” SH.P.K.**

Kjo Marrëveshje bashkimi me perthithje eshte hartuar nga Administratori i shoqerise "Concord Investment" sh.p.k. Z. Adrian Dulaku dhe Administratori i shoqerise "Iliria Development" sh.p.k. Z. Artan Dulaku. Te dhenat e dy shoqerive paraqiten si me poshte:

1. **“CONCORD INVESTMENT” SH.P.K.**, person juridik shqiptar, i regjistruar më datën 14.06.2005, me Vendimin Nr. 33729, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me seli në adresën: rruga “Perlat Rexhepi” Nd.1. H 14, Ap 7, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, Shqipëri, me NUIS K81602049K, e përfaqësuar nga **Z. Adrian Dulaku**, me cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, që këtu më poshtë, për efekt të kësaj marrëveshje, do të quhet **“SHOQËRIA PËRTHITHËSE”**;

DHE

2. **“ILIRIA DEVELOPMENT” SH.P.K.**, person juridik shqiptar me NUIS K72208033U, dhe me seli në adresën "Rruga Perlat Rexhepi", Ndertesë nr. 1, Hyrja nr. 14, Ap. 7, NJA nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, përfaqësuar nga Z. Artan Dulaku, me cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, që këtu më poshtë, për efekt të kësaj marrëveshje, do të quhet **“SHOQËRIA E PËRTHITHUR”**;


DEKLARATA PARAPRAKE

- A. Kjo Marrëveshje hartohet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, Neni 215 e vijim;
- B. Shoqeria Perthithese "Concord Investment" sh.p.k., ka si ortake te saj Shoqerine Z. Adrian

Dulaku, Z. Artan Dulaku dhe Z. Genci Dulaku;

- C. Shoqeria e Perthithur "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. ka si ortak te vetem te saj z. Artan Dulaku;
- D. "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. dhe "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. deshirojne te kryejne nje Bashkim mes tyre, nepermjet te cilit "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. do te perthithe shoqerine "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. Ne kete menyre, shoqeria "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. do te vazhdoje aktivitetin kurse shoqeria "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. do te crregjistrohet pa kaluar ne likujdim.
- E. Qëllimi i bashkimit me përthithje është përqendrimi i kapitalit dhe fuqisë punëtore në shoqërinë "CONCORD INVESTMENT" Sh.p.k., si dhe rritja e rendimentit dhe përfitimi i një efekti strategjik, ulja e kostove, rritja e numrit të klientëve, konkurenca, përftimi i një pozicioni më të fortë në treg, si dhe rritja e të ardhurave, duke rritur efikasitetin dhe për të zvogëluar shpenzimet. Në përputhje me pritshmërinë e Shoqërive, përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe otakëve të tyre, bashkimi i Shoqërive duket i arsyeshëm dhe i dobishëm.
- F. Me Vendimet nr. 10, datë 18.06.2021 dhe nr.1, date 18.06.2021, respektivisht, te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise Perthithese "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k dhe asaj te Perthithur "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. eshte kerkuar dhe miratuar: *"Fillimi i procedurave per bashkimin nepermjet perthithjes te Shoqerise "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. nga Shoqeria "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k."*
- G. Ortakët e të dy shoqerive shprehin dakordesine per aplikimin e pikes 7, te nenit 216 dhe pikes 5 te nenit 217 të Ligjit Nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.
- H. Dy shoqerite kane rene dakord per kete marreveshje ashtu si parashikohet në nenin 216 te Ligjit.

Te dyja shoqerite kane rene dakord si meposhte vijon:



Neni 1

PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Ne kete Marreveshje, pervecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilesohet ndryshe me tej, fjalet e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:

- a. **"Marreveshje"** nenkupton kete Marreveshje
- b. **"Shoqeri Perthithese"** i referohet Shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k.
- c. **"Shoqeri e Perthithur"** i referohet shoqerise "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k.
- d. **"Data e Realizimit Perfundimtar te Bashkimit" (Data Efektive e Bashkimit)** ka kuptimin qe i eshte dhene ne nenin 2.1 qe do te thote data e miratimit te Projekt-Marreveshjes nga asambleja e Ortakeve te shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k dhe shoqerise "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k.
- e. **"Data e Bashkimit"** ka kuptimin qe i eshte dhene ne nenin 2.4.
- f. **"Informacion konfidencial"** nenkupton do informacion, me shkrim ose me goje ne lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete te tjera te dy shoqerive.
- g. **"Data e nenshkrimit"** nenkupton daten e nenshkrimit te Projekt-Marreveshjes.

Neni 2

BASHKIMI, KAPITALI DHE KEMBIMI I AKSIONEVE

2.1 Ne baze te kushteve te kesaj Marreveshje, "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k do te perthithe shoqerine "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k ne Daten e Realizimit Perfundimtar te Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) qe eshte data e miratimit te Marreveshjes nga Ortaket e te dy Shoqerive. Dokumentacioni perkates per kete bashkim do te depozitohet ne Qendren Kombetare Biznesit (QKB).

2.2 "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. do t'i transferoje shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. teresine e elementeve te aktivitetit te pasivitetit duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera gjate periudhes ushtrimore deri ne Daten Efektive te Bashkimit.

2.3 Si rezultat i operacionit te Bashkimit, kapitali i Shoqerise Perthithese "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. ne Daten Efektive te Bashkimit do perbehet nga shuma e kapitaleve te dy shoqerive ne daten e Marreveshjes, pa ndryshuar perqindjet takuese te ortakeve vlera e kapitalit te te cileve pas bashkimit do te jete: **Artan Dulaku 34% - 236'961'640 leke; Adrian Dulaku 33% - 229'992'180 leke; Genci Dulaku 33% - 229'992'180 leke.**

2.4 Data e Bashkimit eshte data 18.06.2021 qe do te thote se te gjitha operacionet qe mund te kryhen nga Shoqeria e Perthithur nga kjo date deri ne daten e regjistrimit perfundimtar ne

Qendren Kombetare te Biznesit do te konsiderohen si te kryera nga "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k.

2.5 Statuti i shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k., pas ndryshimeve qe mund t'i behen ne Objektin e veprimtarise, do te vazhdoje te jete edhe Statuti i Shoqerise Pethithese.

2.6 Anetaret e Organeve drejtuese te Shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. ne daten e realizimit Perfundimtar te Bashkimit do te vazhdojne te jene anetare te organeve te Shoqerise Perthithese.

2.7 Administratore te shoqerise Perthithese do vazhdojne te jete Z. Adrian Dulaku dhe Z. Artan Dulaku te cilet do te ushtrojne kompetencat e administrimit te shoqerise se bashkuar sipas ligjit dhe statutit te shoqerise.

2.8. Ortaket e Shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. para perthithjes do te jene Ortake me te njejtat kuota dhe perqindje edhe ne Shoqerine Perthithese.

NENI 3

AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PER TU TRANSFERUAR

Ne kuadrin e ketij operacioni bashkimi parashikohet qe "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. t'i transferoje shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. teresine e elementeve te aktivitetit te pasivitetit gjendje me date 31.12.2020. Pasqyrat financiare vjetore/raportet e ecurisë së veprimtarisë për tre vitet e fundit qe jane marre si baze per hartimin e Projekt-Marreveshjes se bashkimit janë paraqitur bashkëlidhur projekt-marrëveshjes dhe procedures se ndjekur per Fazen e Parë të Bashkimit, respektivisht, si për Shoqërinë Përthithëse, ashtu edhe për atë të Përthithur.

NENI 4

MODALITETET DHE GARANCITE

4.1. Shoqeria "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. do te jete zoteruese e te gjitha aktiveve dhe pasiveve te shoqerise "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. ne daten e bashkimit.

4.2. Shoqeria Perthithese ne daten e Realizimit Perfundimtar te Bashkimit do te zoteroje te gjitha te drejtat e detyrimet, si edhe licensat e zoteruara nga Shoqeria e Perthithur ne ate date.

4.3. Punonjesit e shoqerise se perthithur do te perfshihen pas dates se bashkimit si punonjes te shoqerise perthithese.

4.4. Themelore ne kete procedure bashkimi me perthithje e shoqerive te mesiperme, eshte garantimi i kreditorëve te shoqerive te perfshira ne kete bashkim, sidomos ata te shoqerise

se perthithur (nese ka), per faktin se megjithese debitori fillestar humbet (pra shoqeria e perthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen shoqerise perthithese. Si rezultat, Shoqeria Perthithese merr persiper sipas ligjit te behet pasardhese e Shoqerise se Perthithur ne marredhenie me te tretet, duke garantuar ne kete menyre kreditoret e kesaj te fundit t'i drejtojne pretendimet e tyre ndaj shoqerise perthithese.

NENI 5

DATA KONTABEL

Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k nga data 18 Qershor 2021 deri ne daten e regjistrimit perfundimtar te procesit te bashkimit prane QKB, date ne te cilin do te ndodhe çregjistrimi pa likujdim i Shoqerise se Perthithur, do te konsiderohen si te kryera nga Shoqeria Perthithese dhe rregjistrimet kontabel perkatese do te merren ne librat e saj.

NENI 6

DATA E PERGATITJES (HARTIMIT) TE LLOGARIVE

Llogarite qe jane perdorur per te percaktuar kushtet financiare te bashkimit per kete bashkim me perthithje, jane hartuar duke iu referuar dates 31.12.2020, si per shoqerine perthithese ashtu edhe per shoqerine e perthithur.

NENI 7

RAPORTET E KEMBIMIT TE KUOTAVE

Duke konsideruar se ortaku i vetem i Shoqerise se Perthithur eshte nje nga tre ortaket e Shoqerise Perthithese, perqindjet e kapitalit te te cileve nuk ndryshojne pas bashkimit, nuk ka raporte te kembimit te kapitalit.

NENI 8

SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TE BASHKIMIT

Nga operacioni i mesiperm nuk do te rezultojne prim nga bashkimi.

NENI 9

TE DREJTA DHE AVANTAZHE TE VECANTA



Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

NENI 10 PREMTIME DERI NE MBYLLJE

Deri ne daten e mbylljes, Palet duhet qe:

- a) Te kene ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme miratimin e Marreveshjes.
- b) Te ndermarrin cdo veprim per depozitim e te gjitha dokumentave ne QKB brenda dates 19.07.2021 per ti dhene efekt Bashkimit ne Daten Efektive.

NENI 11 MBYLLJA E OPERACIONIT

Mbyllja e procesit te Bashkimit do te behet ne seline e shoqerise "CONCORD INVESTMENT" sh.p.k. Ne mbyllje ose para saj palet duhet te kene bere te mundur realizimin dhe dorezimin e dokumentave te meposhtme:

- a) Te gjitha vendimeve te Asambleve dhe Keshillit Mbikqyres ne lidhje me kete operacion.
- b) Njoftimet perkatese ne zyrat e taksave ne lidhje me operacionin e mesiperm.
- c) Kalimin e punonjesve nga Shoqeria e Perthithur ne shoqerine perthithese.

NENI 12 DEKLARIMET DHE GARANCITE

Deklarimet dhe Garancite e CONCORD INVESTMENT SH.P.K.


CONCORD INVESTMENT SH.P.K. dhe perfaqesuesi i saj kate gjithë fuqine dhe autoritetin e kerkuar per te kryer kete Marreveshje dhe nenshkruar e miratoje cdo dokument tjeter qe duhet kryer ne perputhje me kete te fundit.

CONCORD INVESTMENT SH.P.K. nuk eshte ne nje proces falimentimi (apo procese te tjera te ngjashme), ne shkrirje ose ne proces likujdimi.

Deklarimet dhe Garancite e "ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k.:

"ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. dhe perfaqesuesi i saj kate gjithë fuqine dhe autoritetin e kerkuar per te kryer kete Marreveshje dhe nenshkruar e miratoje cdo dokument tjeter qe duhet kryer ne perputhje me kete te fundit.

"ILIRIA DEVELOPMENT" sh.p.k. nuk eshte ne nje proces falimentimi (apo procese te tjera te



ngjashme), ne shkrirje ose ne proces likujdimi.

Neni 13

ZGJIDHJA E MARREVESHJES

Kjo Marreveshje nuk mund te perfundoje, pervec se me vullnetin e dy paleve deri para regjistrimit te bashkimit te QKB, me ane te njoftimit me shkrim drejtuar pales tjeter.

Neni 14

KONFIDENCIALITETI

Palet do te trajtojne ne menyre konfidenciale te gjitha informacionet e marra dhe te perftuara si rezultat i nisjes dhe permbushjes se kesaj Marreveshje, te cilat kane lidhje me negociatat, per mbushjen dhe mbylljen e kesaj Marreveshje ose te cdo dokumenti qe referohet nga kjo Marreveshje. Palet mund t'i japin informacion nje pale te trete, i cili mund te konsiderohet konfidencial nese:

- a) Kerkohet nga ligji ose me qellim te ndonje procedure ligjore
- b) Kerkohet nga ndonje institucion shteteror;
- c) Me miratimin paraprak me shkrim te pales tjeter.

NENI 15

LIGJI I ZBATUESHEM

Kjo Marreveshje rregullohet ne te gjitha aspektet nga Legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 16


TE PERGJITHSHME

Kjo Marreveshje bashkimi do te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit së bashku me vendimet e dy Asambleve dhe p[rocesverbalet e mbledhjeve respektive, siç parashikohet nga ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

NENI 17

TENDRYSHME

- a) Te gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kerkuara apo dhe te lejuara nga kjo Marreveshje do te dorezohen dorazi ose me ane te postes ne adresat e vena ne



b) Asnje ndryshim i kesaj Marreveshje nuk do te jete i vlefshem pervecse me shkrim dhe e nenshkruar nga palet.

Kjo Marreveshje u hartua sot me date 19.07.2021, ne 6 kopje orgjinale dhe u nenshkrua si me poshte:

“ILIRIA DEVELOPMENT” Sh.P.K.

Administratori

Artan DULAKU



“CONCORD INVESTMENT” Sh.P.K.

Administratori

Adrian DULAKU

